

Për Kryesusin e Kuvendit Komunal

Raport i punës së Komitetit të Arsimit në periudhën Janar -Mars 2011

Komiteti i Arsimit si trupë profesionale me përfshirjen e gjitha subjekteve politike duke u mbështetur në:

- **Ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm,**

- **Udhëzimet administrative dhe**

- **Rregulloret komunale**

Ka për obligim ta monitoroj dhe ndihmoj në vazhdimsi punën e DKA-së dhe mvarësisht nga nevojat e paraqitura të nxjerr rekomandime drejtuar Kuvendit Komunal për të marrë vendime që janë në interesin dhe avancimin e arsimit në Gjilan.

Komiteti i Arsimit objektivat e veta i realizoj nëpërmjet mbajtjes së takimeve të rregullta dhe aktiviteteve në faza të caktuara.

Fillimisht dua të theksoj që është aritur të konsolidohet në tërësi komiteti i Arsimit me zgjedhjen e kryesuesit dhe me mbajtjen e takimeve të rregullta. Kjo ka bërë që të gjithë anëtarët të jenë të angazhuar për ta dhënë kontributin e tyre në zgjidhjen a qështjeve të ndryshme që rëndojnë Drejtorin e Arsimit .

Gjatë kësaj periudhe komiteti ka mbajtur katër takime, tri prej të cilave të rregullta dhe njera e jashtëzakonshme.

Po ashtu e falemderoj drejtorin e Arsimit për bashkëpunimin korrekt i cili na ka sjellë informatat dhe raportet e kërkuara nga Komiteti.

Komiteti i Arsimit në takimin e parë është informuar nga drejtori i arsimit për raportin e suksesit të gjysëmvetorit të parë 2010-2011 me çrast komiteti ka vlerësuar pozitivisht raportin e suksesit të paraqitur nga DKA-ja, por edhe janë kërkuar informata për disa nxënës të pa notuar dhe nxënës që e kanë braktisur mësimin. Po ashtu janë dhënë vërejtje edhe për bashkëpunimin jo të duhur nga ana e prindërve në raport me mësimdhënësit. Në këtë takim është kërkuar nga përfaqësuesi i OSCE-së të paraqitet plani i punës së komitetit.

Në takimin e dytë përveç miratimit të planit të punës, komiteti e ka parë të nevojshme rishikimin e kriterëve për punësimin e punëtorëve arsimorë, dhe pasi ka analizuar në tërësi kriteret kemi pajtuar me konsensus të plotë që ti **rekomandojmë** DKA-së që të mirren për bazë në konkursin e ardhshëm sygjerimet e paraqitura nga ana e komitetit.

Komiteti është pajtuar dhe i ka **rekomandu** Kuvendit Komunal ndarjen e 50 bursave për studente si dhe ndarjen e 20 shpërblimeve studentët e dalluar me mesatare të lart, kjo e fundit është bërë për herë të parë.

Kemi kërkuar nga komisioni disiplinor, komision i zgjedhur nga kuvendi komunal, informat për masat e ndërmara disiplinore.

Pas analizes të këtij raporti, komiteti ka konstatu se këto veprime kanë qenë të duhura dhe se e kanë rritur shkallen e përgjegjësisë si nga ana e nxënësve ashtu edhe nga ana e prindërve dhe është vërejt një mobilizim i theksuar që ka rezultu me ngritjen e disiplinës në shkollat tona.

Kemi kërku informata edhe kemi ngrit qështje për:

- Rastet që e kanë braktisur shkollen,
- Vonsesa e publikimit të konkursit për puntorët teknik dhe sekretaret e disa shkollave.
- Emertimit të dy shkollave të Gjilanit,
- Sigurin në shkolla, ku nga drejtorja jemi informu që prioritet i parë për këtë vit do të jetë rregullimi i rrethojave në kompleksin e shkollave .
- Zëvendësimin neper shkolla si psh, zëvendesimet e pushimeve të lehonisë se me çfar kriteriumi punsohen.
- Informat se kur do te inagurohet shkolla Agim Ramadani dhe se deri ku kan mberri punët me aneksin e gjimnazit të ri, si dhe disa informata tjera më shumë të natyrave teknike.

Në takimin e jashtezakonshem kemi bërë plotesimin e rekomandimeve me kriteret për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve, ku të gjitha kriteret janë miratuar me konsensus nga ana e komitetit.

Komiteti është i kënaqur me punen që po bën drejtorja e Arsimit si me paisjen e disa kabineteve informative të dhëna donacione nga organizata të ndryshme, paisjen e disa shkollave me kamera që po ashtu ka ngritur nivelin e përgjegjësisë të personelit mësimor, personelit teknik si dhe disiplines dhe siguris së nxënësve, ndërtimin e sallave sportive dhe aktiviteteve tjera.

Ne asnjëherë nuk jemi të kënaqur me punen që e kemi bërë sepse e dimë që para vetes kemi sfida të medha, por jemi të përkushtuar që me angazhimin tonë të arrijm ta përmbushim planin që e kemi miratuar dhe unë që po e paraqes këtë raport dua të theksoj se në komitetin tonë egziston fryma pozitive e punës dhe gjithë anetaret po japin kontributin e tyre në zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me arsimin gjilanas.

Më 04.04.2011

Kryesuesi i Komitetit

Shkëlqim Latifi
